

# Të votosh

Zgjedhjet më 9 shtator 2018.  
Kështu voton në zgjedhjet parlamentare,  
komunale dhe  
për kuvend të Këshillit të Qarkut.



## Kush ka të drejtë të votojë?

Për të pasur të drejtë vote, ti duhet t'ij kesh mbushur 18 vjet, deri më ditën e zgjedhjeve. Të dhënat në regjistrin e Gjendjes Civile 30 ditë para ditës së zgjedhjeve, janë vendimtare nëse ti ke të drejtë vote dhe cilit rajon zgjedhor i përket.

Ti ke të drejtë votimi për parlament, nëse ti je:

- shtetas suedez dhe je ose ke qenë i/e regjistruar në Gjendjen Civile në Suedi.

Ti ke të drejtë votimi për kuvendin komunal dhe për kuvend të Këshillit të Qarkut, nëse ti je:

- shtetas suedez dhe je i/e regjistruar në Gjendjen Civile në Suedi.
- shtetas i ndonjë shteti anëtarë të Unionit Evropian ose shtetas i/e Islandës ose Norvegjisë dhe je i regjistruar në Gjendjen Civile në Suedi.
- je shtetas i/e ndonjë vendi tjetër dhe ke qenë i regjistruar në Gjendjen Civile në Suedi, tri vjet rresht para ditës së zgjedhjeve.

## Ti që ke të drejtë vote merr një kartë votimi (një fletë votimi)

Ti që ke të drejtë vote merr, përmes postës, një kartë votimi, rreth tri javë para zgjedhjeve. Në kartën e votimit shkruan se për cilat zgjedhje ke të drejtë të votosh, si dhe emri, adresa dhe orari i punës për lokalitetin tënd të zgjedhjeve. Në kartë të votimit ka edhe informacion për lokalet për votim të parakohshëm. Nëse ti do të votosh para kohe, ti duhet ta marrësh me vete kartën tënde të votimit.

Nëse ti nuk e ke marrë kartën tënde të votimit, ose nëse e ke humbur atë, ti mund ta porositësh një kartë tjetër në komunë ose në Organin Zyrtar të Zgjedhjeve.

## Fletëvotimet

Fletëvotimet janë të verdha për zgjedhjet parlamentare, të bardha për zgjedhjet e kuvendit komunal dhe blu për zgjedhjet e kuvendit të Këshillit të Qarkut. Fletëvotime ka në të gjitha vendet ku ti mund të votosh, si dhe tek partitë. Nëse ti voton para kohe, ose nëse voton përmes një lajmëtari, mund të kesh nevojë të porositësh ose të marrësh fletëvotimin nga partitë ose nga komuna jote.

## Voto për partinë

Ti, para së gjithash, voton për një parti. Emri i partisë është i shënuar në fletëvotimin e zgjedhjeve. Nëse ti nuk e gjen fletëvotimin e partisë tënde, ti mund të marrësh një fletëvotim bosh dhe të shkruash emrin e partisë në të, sa më qartë që është e mundur.

## Voto për personin

Nëse ti dëshiron që ndonjë kandidat i veçantë i partisë tënde të zgjidhet, ti mund t'ia japësh atij personi një votë të personit, duke e vënë



një kryq përpara katrorit me emrin e kandidatit në fletëvotim. Ti mund të vësh një kryq, vetëm për një kandidat.

## Ti duhet të tregosh, se ti je ti

Për të pasur të drejtë të votosh, ti duhet të mund vërtetosh identitetin tënd, duke e treguar një dokument identifikimi, p.sh. patentë shoferi ose pasaportë. Nëse ti nuk ke ndonjë dokument identifikimi, mundet një person tjetër të vërtetojë identitetin tënd, por atëherë ai person duhet të tregojë një dokument identiteti.

## Votimi

### Voto në lokalit tënd të votimit, ditën e zgjedhjeve

Ti mund të votosh vetëm në atë lokal të zgjedhjeve që është i shënuar në kartën tënde të votimit. Lokali i zgjedhjeve është hapur, vetëm ditën e zgjedhjeve. Kur ti të votosh në lokalit tënd të zgjedhjeve, shënohesh në listën e votimit dhe votën tënde e fut në kuti të fletëvotimeve.

### Voto para kohe në komunën tënde ose në një komunë tjetër

Votimi i parakohshëm do të thotë, se ti voton në një vend tjetër nga lokali yt i zgjedhjeve. Votimi i parakohshëm fillon rreth tri javë para ditës së zgjedhjeve dhe zgjatë deri ditën e zgjedhjeve.

Ti duhet ta kesh me vete kartën e votimit, kur ti voton para kohe, pasi që ajo përdoret për ta dërguar votën tënde në lokalit tënd të zgjedhjeve. Atje numërohet vota jote.

Ti mund të informohesh, se ku mund të votosh para kohe, përmes [www.val.se](http://www.val.se) ose nga komuna jote.

### Voto nga vendi i jashtëm

Nëse ti je jashtë shtetit, ti mund të votosh përmes letrës ose të votosh në shumë ambasada dhe konsullata suedeze. Për të votuar përmes letrës, ti ke nevojë të kesh material të cilin e porositë nga Organi Zyrtar i Zgjedhjeve. Ti mund të votosh, jo më herët se 45 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe të votosh në ambasada dhe konsullata, jo më herët se 24 ditë para ditës së zgjedhjeve.

## Disa mund të votojnë me lajmëtar

Ti mund të votosh me lajmëtar, nëse ti për shkak të moshës së lartë, për shkak të sëmundjes ose zvogëlimit të funksionit, nuk mundesh vet të shkosh në lokalit tënd të zgjedhjeve ose në lokalit e votimit. Atëherë mundet burri, gruaja ose bashkëjetuesi/-sja ose fëmijët e burrit, gruas ose të bashkëjetuesit/ -ses, nipat/ mbesat, prindërit ose vëllezërit/motrat, mund të jenë lajmëtar. Nëse është dikush që profesionalisht ose të ngjashme, të ofrojnë kujdes shëndetësor ose ka zakon të ndihmojë, ai person mundet, edhe të jetë lajmëtar.

Ti, po ashtu, mund të votosh me lajmëtar nëse ti je i paraburgosur ose në një institucion ndëshkues-korrektues. Atëherë mundet, edhe personeli të ndihmojë ty. Nëse banon përgjatë një linje të postierit të fshatit, postieri i fshatit mund të jetë lajmëtar për ty. Nëse ti nuk njeh dikë i cili mund të jetë lajmëtar i yti, komuna jote mund të organizojë pranues të votave, i cili vjen në shtëpi tek ti. Kontakto komunën tënde.

Për të votuar me lajmëtar, ti ke nevojë për një material të veçantë, të cilin e porositë nga komuna ose nga Organi Zyrtar i Zgjedhjeve.